Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008), bazuar në nenin 81 të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr.05/L-068, Ligjin Nr.05/L-092, bazuar në Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja, shqyrtoj kërkesën e Prokurimit të datës 26.04.2022, për caktimin e menaxherëve të kontratave dhe Mbikëqyrësit të drejtpërdrejt të Menaxherëve të kontratave për projektin: “Riparimi i rrugëve lokale të rendit të IV” nxjerr:

V E N D I M

- 1. CAKTOHET:** Menaxher i kontratës **Naser Nimanaj**, Zyrtar i Lartë për Infrastrukturë Rrugore në Drejtorinë për Shërbime Publike dhe Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës **Abedin Kabashi**, Drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike për projektin: “Riparimi i rrugëve lokale të rendit të IV”, me numër të jashtëm prokurimi 633-022-1009-1-2-1 dhe me numër të brendshëm prokurimi 633-022-005-121, të cilin projekt e ka fituar për ta realizuar operatori “**Shkambi**” **SH.P.K** nga Istogu.
- 2.CAKTOHET:** Menaxher i kontratës **Enisa Ćorović**, Zyrtare për Koordinimin e të Drejtave dhe Integrim të Komuniteteve në ZLKK dhe Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës **Rasim Mahutović**, Udhëheqës i Sektorit për Komunitete dhe Kthim për projektin: “Riparimi i rrugëve lokale të rendit të IV”, me numër të jashtëm prokurimi 633-022-1009-1-2-1 dhe me numër të brendshëm prokurimi 633-022-005-121, të cilin projekt e ka fituar për ta realizuar operatori “**Shkambi**” **SH.P.K** nga Istogu.
- Menaxheret e kontratës dhe Mbikëqyrësit e drejtpërdrejt të Menaxhereve të kontratës obligohen që të bëjë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës duke zbatuar nenin 61 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01, si dhe Manualët për Përdorim të Modulit për Menaxhim të Kontratës.
- Përgjegjësin për realizimin e projektit të lartcekur e marrin Menaxheret e kontratës dhe Mbikëqyrësit e drejtpërdrejt të Menaxhereve të kontratës.
- Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.
- Vendimi është përfundimtar.

Vendimi t'i dërgohet:

- Naser Nimanaj,
- Abedin Kabashi, Drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike,
- Enisa Ćorović,
- Rasim Mahutović, udhëheqës i Sektorit për Komunitete dhe Kthim dhe
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj. Zekije SUTAJ




Kryetari Komunës-ZKA
z.Illir FERATI



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-239/2022	Data: Datum: 22.04.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenin 46, 47. dhe 48. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016) dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014. Komisioni për shqyrtimin e kërkesave të qytetarëve për përkrahje financiare në shëndetësi, shqyrtoi kërkesën Nr.06-553-15296 të datës 20.04.2022, të parashtruar nga z.Sulo Ahmetaj nga Gurakoci, Komuna e Istogut, për përkrahje me karburant për marrjes e kimioterapisë në QKUK në Prishtinë dhe i propozon Kryetarit të nxjerri:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa Nr.06-553-15296 e datës 20.04.2022 e parashtruar nga **z.Sulo Ahmetaj** për përkrahje me karburant, për marrjes e kimioterapisë në QKUK në Prishtinë dhe i lejohen **50 litra karburant**.
2. Obligohet Zyrtari i transportit që z.Sulo Ahmetaj të pajisë me vërtetim për furnizim me karburant të automjetit si në pikën 1. të këtij Vendimi, në pajtim me procedurat të cilat vlejné për furnizim me karburant të automjeteve zyrtare, nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi.
3. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij, do të kujdeset: Drejtoria për Shëndetësi dhe Zyrtari i Transportit.
4. Vendimi është përfundimtarë.

A r s y e t i m

z.Sulo Ahmetaj, ka parashtruar kërkesën Nr.06-553-15296 e datës 20.04.2022, me të cilën ka kërkuar që t'i mundësohet furnizimi me karburant për automjetin më të cilin bëhet transportimi i tij në QKUK- Prishtinë për marrjen e kimioterapisë. Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurit dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton.

Nga kërkesa e parashtruar dhe raportet mjekësore shihet se Sulo Ahmetaj është i sëmurë nga kanceri dhe i ndihmohet me 50 litra karburant për mbushjen e veturës për dërgimin e tij për marrjen e kimioterapisë në QKUK në Prishtinë.

I lartpërmenduri është në gjendjen ekonomiko sociale jo të mirë dhe nuk ka mundësi familja me i bartë të gjitha shpenzimet e transportit për dërgimin e tij për rrezatime në Prishtinë.

Zyrtari i transportit, Sulon do të pajisë më vërtetim për furnizim me karburant nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi në pajtim me procedurat që vlejné edhe për automjetet zyrtare.

Drejtorja për Shëndetësi do të kujdeset që të bëhet furnizimi i automjetit me karburant dhe do të përcjellë realizimin e këtij Vendimi.

Për sa u tha me lartë u vendos si në diapozitiv të këtij Vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi t'i dërgohet:

- z.Sulo Ahmetaj,
- Drejtorisë për Shëndetësi,
- Zyrtarit të Transportit dhe
- Arkivin e zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj. Zekije SUTAJ

Zekije SUTAJ



	KRYETARI I KOMUNËS PRESDENIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		
Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	Nr.Br. 01-238/2022	Data: Datum: 22.04.2022	Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality

Kryetari i Komunës, bazuar ne nenin 13 dhe 58 pika b). të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), ne nenin 46, 47 dhe 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Komisioni për vlerësim dhe shqyrtim të kërkesave shëndetësore për përkrahje financiare, shqyrtoi kërkesën Nr.06-553-5590 të datës 09.02.2021 të parashtruar nga z.Smajl Osmanaj, nga fsh. Cerrcë, Komuna e Istogut, për ofrim të ndihmës financiare për shërim, dhe i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa Nr.06-553-5590 e datës 09.02.2022, për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërimin e tij dhe i ndahen **150.00€ (njëqind e pesëdhjetë euro)** nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi, si ndihmë momentale për shërim.
2. Mjetet e cekura do të transferohen në xhirollogarinë e Smajl Osmanaj, në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësi.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Drejtoria për Shëndetësi.
4. Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

z.Smajl Osmanaj, ka parashtruar kërkesën Nr.06-553-5590 të datës 09.02.2021, me të cilën ka kërkuar t'i ndahen mjete financiare për blerjen e terapisë për shërim.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendures dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton.

Nga shkresat e parashtruara në lëndë dhe raportet mjekësore shihet se Smajli është i sëmurë dhe si pasojë e kësaj ka nevojë për blerjen e terapisë të cilat janë mjaftë të kushtueshme.

I përmenduri është në gjendje jo të mirë ekonomike dhe kjo i pamundëson që me mjete vetanake ti blejë barnat për shërimin të cilat janë mjaftë të kushtueshme.

Në plan programin buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi është përcaktuar pozicioni për subvencione dhe transfere, mjete nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë individëve si ndihmë momentale për shërim.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e Smajl Osmanaj, në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike.

Për sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi t'i dërgohet:

- Smajl Osmanaj,
- Drejtorisë për Shëndetësi dhe
- Arkivin e zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj. Zekije SUTAJ



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-237/2022	Data: Datum: 22.04.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenin 46, 47. dhe 48. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016) nenin 68.1 pika 2 të Statutit të Komunës 01Nr.62/10 i miratuar me 30.11.2010 dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Drejtoria për Shëndetësi, shqyrtoi kërkesën Nr.06-553-15696, të datës 22.04.2022, të parashtruar nga z.Skender Nurçaj nga fsh. Kashicë, Komuna e Istogut, për përkrahje me karburant për dërgimin e bashkëshortes Fatime Nurçaj në Sistina në Maqedoni dhe i propozon Kryetarit të nxjerri:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa Nr.06-553-15696 e datës 22.04.2022 e parashtruar nga z.Skender Nurçaj, për përkrahje me karburant për dërgimin e bashkëshortes Fatime Nurçaj në Sistina në Maqedoni për marrjen e terapisë mjekësore dhe i lejohen 300 litra karburant.
2. Obligohet Shefi i autoparkut që të pajisë z.Skender Nurçaj, me vërtetim për furnizim me karburant të automjetit, në sasinë e cekur në pikën 1. të këtij Vendimi, në pajtim me procedurat të cilat vlejné për furnizim me karburant të automjeteve zyrtare, nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi.
3. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij, do të kujdeset: Drejtoria për Shëndetësi dhe Zyrtari i Transportit.
4. Vendimi është përfundimtarë.

A r s y e t i m

z.Skender Nurçaj, ka parashtruar kërkesën. Nr.06-553-15696 të datës 22.04.2022, me të cilën ka kërkuar që t'i mundësohet furnizimi me karburant për automjetin më të cilin bëhet transportimi i bashkëshortes së tij në Sistina në Maqedoni për marrjen e terapisë mjekësore

Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurit dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton.

Nga kërkesa e parashtruar dhe raportet mjekësore shihet se znj.Fatmire Nurçaj është e sëmurë dhe i ndihmohet me 300 litra karburant për mbushjen e veturës për dërgimin e saj për marrjen e terapisë në Sistina në Maqedoni.

I lartpërmenduri është në gjendjen ekonomiko sociale jo të mirë dhe nuk ka mundësi familja me i bartë të gjitha shpenzimet e transportit për dërgimin e saj për në Maqedoni për marrjen e terapisë.

Zyrtari i transportit do të pajisë të përmendurin më vërtetim për furnizim me karburant nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi në pajtim me procedurat që vlejné edhe për automjetet zyrtare.

Drejtorja për Shëndetësi do të kujdeset që të bëhet furnizimi i automjetit me karburant dhe do të përcjellë realizimin e këtij Vendimi.

Për sa u tha me lartë u vendos si në diapozitiv të këtij Vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi t'i dërgohet:

- Skender Nurçaj,
- Drejtorisë për Shëndetësi,
- Zyrtarit të Transportit dhe
- Arkivin e zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj. Zekije SUTAJ





	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		
Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	Nr.Br. 01-236/2022	Data: Datum: 22.04.2022	Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), në nenin 59 paragrafi 1 i Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.18/2011), në nenin 40 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja, shqyrtoj kërkesën e Prokurimit të datës 16.03.2022 për themelimin e Komisionit vlerësues të tenderit: Lot 1“Furnizimi me dokumente mjekësore”; Lot 2”Servisimi dhe riparimi i rëntgenit”; me numër të jashtëm prokurimi 633-022-2448-1-2-1 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-022-008-121, nxjerr:

V E N D I M

1.THEMELOHET: Komisioni vlerësues i tenderit: Lot 1“Furnizimi me dokumente mjekësore”; Lot 2”Servisimi dhe riparimi i rentgenit”; me numër të jashtëm prokurimi 633-022-2448-1-2-1 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-022-008-121 dhe në komision caktohen:

- 1.1. Brahim Hetemaj,** Udhëheqës i Sektorit për Shëndetësi, Kryesues i Komisionit;
- 1.2. Fisnik Shoshi,** Zyrtar Ligjor 2, anëtar dhe
- 1.3. Idriz Imeraj,** Zyrtar për Logjistik 1, anëtar.

2. Komisioni i cekur me lartë, ka për obligim që të bëjë vlerësimin e të gjitha ofertave konkurruese në pajtim me kriteret e specifikuar në dosjen e tenderit: Lot 1“Furnizimi me dokumente mjekësore”; Lot 2”Servisimi dhe riparimi i rëntgenit”; me qëllim të konstatimit të tenderit të vlerësuar si me i miri si dhe do t’i kryejë të gjitha punët dhe përgjegjësit tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

3. Të gjithë anëtarët e komisionit i nënshtrohen rreptësisht dispozitave të nenit 11 të LPP-së në lidhje me mbrojtjen e informatave sekrete të ofertave.

4. Anëtarët e komisionit vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin teknik të ofertës sipas nenit 40 paragrafi 40.3 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja.

5. Zyrtari përgjegjës i prokurimit do të organizoj, këshilloj dhe drejtoj punën e Komisionit vlerësues dhe do të siguroj respektimin e dispozitave të LPP-së dhe Rregullave të Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja.

6. Obligohen anëtarët e komisionit që në afatin me të shkurtër kohor të prezantojnë pranë zyrës së Prokurimit dhe Prokurimi t’iu ofroj qasje në ofertave që kanë shprehur konkurrencë.

7. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Komisioni, Prokurimi dhe Drejtoria për Shërbime Publike.

8. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi t’i dërgohet:

- Komisionit,
- Prokurimit,
- Drejtorisë për Shëndetësi dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

**Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ**




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-231/022	Data: Datum: 19.04.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar ne nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), ne nenin 46, 47 dhe 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), nenin 68.1 pika 2 të Statutit të Komunës 01Nr.62/10 dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Komisioni për vlerësim dhe shqyrtim të kërkesave shëndetësore për përkrahje financiare, shqyrtoi kërkesën, Nr.06-553-5147 të datës 07.02.2022 e parashtruar nga Sinan Maraj nga fsh. Vrellë, Komuna e Istogut dhe i propozon Kryetarit për ofrim të ndihmës financiare për shërimin e tij, nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa Nr.06-553-5147 e datës 07.02.2022, e parashtruar nga Sinan Maraj, për ofrim të ndihmës financiare për shërim dhe me propozim të Komisionit i ndahen 150.00€(njëqind e pesëdhjetë euro) nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nga programi buxhetor i Zyrës Kryetarit, si ndihmë momentale për shërim.
2. Mjetet e cekura do të transferohen në xhirollogarinë e Sinan Maraj në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësi.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Drejtoria për Shëndetësi.
4. Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

Sinan Maraj, ka parashtruar kërkesën Nr.06-553-5147 të datës 07.02.2022, me të cilën ka kërkuar t'i ndahen mjete financiare për shërim.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurit dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton.

Nga shkresat e parashtruara dhe raportet e mjekëve shihet se Sinani është i sëmurë dhe si pasojë e kësaj ka nevojë për shërim, i cili shërim është mjaftë i kushtueshëm.

I përmenduri është në gjendje jo të mirë ekonomike dhe nuk ka asnjë burim të rregullt të të ardhurave dhe kjo i pamundëson që me mjete vetanake të bëjë blerjen e barnave të nevojshme për shërim.

Në plan programin buxhetor Zyrës Kryetarit, është përcaktuar edhe pozicioni i subvencioneve dhe transfereve, mjete nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë individëve si ndihmë momentale për shërim.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e tij në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike.

Për sa u theksua u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Vendimi t'i dërgohet:

- Sinan Maraj,
- Drejtoria për Shëndetësi,
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
 znj.Zekije SUTAJ



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-228/2022	Data: Datum: 15.04.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovë, Nr.28/2008), në nenin 61 paragrafi 61.27, 61.28, 61.29, 61.30 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja, shqyrtoj kërkesën 09 Nr.51/2022 të datës 09.03.2022 të parashtruar nga Drejtori i Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi për ndërprerjen e kontratave për mos përmbushjen e obligimeve që rrjedhin nga kontratat për projektet: Lot4 “Rregullimi i Përroit Vërshues Kaliçan”; “Betonimi i kanalit Dobrush-Lubovë” të dy projektet me numër të jashtëm prokurimi 633-21-1265-521/C454 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-21-009-521/C454, nxjerr:

V E N D I M

- MIRATOHET:** kërkesa e Drejtorit të Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi për ndërprerjen e kontratës për mos përmbushjen e obligimeve që rrjedhin nga kontratat për projektin: Lot4 “Rregullimi i Përroit Vërshues Kaliçan” me numër të jashtëm prokurimi 633-21-1265-521/C454 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-21-009-521/C454 të cilin e ka fituar për ta realizuar “Lurn” SH.P.K nga Fushë Kosova dhe projekti: “Betonimi i kanalit Dobrush-Lubovë” me numër të jashtëm prokurimi 633-21-1265-521/C454 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-21-009-521/C454 të cilin e ka fituar për ta realizuar Grupi i operatorëve “Lurn” nga Fushë Kosova dhe “Engineering Grup” SH.P.K.
- Obligohet Zyra e Prokurimit të ndërmerr të gjitha masat e nevojshme bazuar në dispozitat ligjore në fuqi për ndërprerjen e kontratave si në piken 1 të këtij vendimi.
- Ky vendim bëhet i plotfuqishëm menjëherë pas nënshkrimit nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe obligohet: Prokurimi të zbatohet.

A r s y e t i m

Drejtori i Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi, ka parashtruar kërkesë me 09Nr.51/2022 të datës 09.03.2022 të datës 09.03.2022, për ndërprerjen e kontratës për mos përmbushjen e obligimeve që rrjedhin nga kontrata për projektin: Lot4 “Rregullimi i Përroit Vërshues Kaliçan” me numër të jashtëm prokurimi 633-21-1265-521/C454 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-21-009-521/C454 të cilin e ka fituar për ta realizuar “Lurn” SH.P.K nga Fushë Kosova dhe projekti: “Betonimi i kanalit Dobrush-Lubovë” me numër të jashtëm prokurimi 633-21-1265-521/C454 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-21-009-521/C454 të cilin e ka fituar për ta realizuar Grupi i operatorëve “Lurn” nga Fushë Kosova dhe “Engineering Grup” SH.P.K. Pas shqyrtimit të kërkesës ZKA-ja miraton kërkesën e Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi dhe njëherit e obligon Zyren e Prokurimit që ti ndërmarr te gjitha masat e nevojshme sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Me sa u tha me lartë-u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi t'i dërgohet:

- Gëzim Ademaj-Udhëheqës i Prokurimit,
- “Lurn” SH.P.K,
- “Engineering Grup” SH.P.K,
- “PMN” SH.P.K,
- Drejtorja për Bujqësi Pylltari dhe Hidroekonomi dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-226/022	Data: Datum: 13.04.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58. pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) në nenin 46, 47. dhe 48. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016) në nenin 68.1 pika 2. të Statutit të Komunës 01 Nr.62/10, dhe bazuar në nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, shqyrtoi kërkesën 01Nr.016-11668 të datës 28.03.2022 të parashtruar nga Mirsad Smakić nga fshati Dobrushë, Komuna e Istogut për përkrahje financiare për transportin e nxënësve të komunitetit boshnjak për në shkollë në relacionin Lobovë-Dobrush dhe anasjelltas, me miratimin e prindërve, nxjerrë:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa 01Nr.016-11668 e datës 28.03.2022 e parashtruar nga Mirsad Smakić, për përkrahje financiare për transportin e nxënësve të komunitetit boshnjak për në shkollë në relacionin Lobovë-Dobrush dhe anasjelltas, me miratimin e prindërve dhe i ndahen mjete financiare në shumë prej **950.00€ (nëntëqindpesëdhjetë euro)** nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nga programi buxhetor i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim.
2. Mjetet e përcaktuara, në pikën 1. të këtij Vendimi, do të transferohen në xhirollogarinë e Mirsad Smakić, në pajtim me dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi.
3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi.
4. Vendimi është përfundimtarë.

A r s y e t i m

Mirsad Smakić, ka parashtruar kërkesën 01Nr.016-11668 të datës 28.03.2022, për përkrahje financiare për transportin e nxënësve të komunitetit boshnjak për në shkollë në relacionin Lobovë-Dobrush dhe anasjelltas, me miratimin e prindërve.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e Mirsad Smakić dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton.

Mirsad Smakić, ka kërkuar mjete financiare në shumë prej **950.00€ (nëntëqindpesëdhjetë euro)** për transportin e nxënësve të komunitetit boshnjak në shkollën "Fan Noli" dhe anasjelltas.

Prindërit kanë lidh marrëveshje me Mirsad Smakić për ti transportuar fëmijët e tyre për në shkollën e lartcekur dhe anasjelltas për në shtëpi, pasi që rruga nga Lubova në Dobrushë është larg nga shkolla dhe fëmijët janë të vegjel.

Në plan programin buxhetor të Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim është përcaktuar edhe pozicioni i subvencioneve dhe transfereve, mjete nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë momentale.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e Mirsad Smakić, në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi.

Për sa u theksua me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi t'i dërgohet:

- Mirsad Smakić,
- Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ

[Signature]



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-225/022	Data: Datum: 13.04.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58. pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) në nenin 46, 47 dhe 49 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016) dhe bazuar në Rregulloren për Mirëmbajtjen, Rregullimin dhe Ruajtjen e Varrezave 01Nr.68/2021 të miratuar me datë 29.06.2021, Drejtoria për Shërbime Publike, shqyrtoi kërkesën 08Nr.120-13887 të datës 08.04.2022 të parashtruar nga Dellta Zenunaj nga fsh.Shushicë, Komuna e Istogut, për përkrahje financiare për shpenzimet e varrimit për vdekjen e babit Naim Zenunaj dhe i propozon Kryetarit të nxjerrë:

V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa 08Nr.120-13887 e datës 08.04.2022 e parashtruar nga Dellta Zenunaj, për përkrahje financiare për shpenzimet e varrimit për vdekjen e babit Naim Zenunaj dhe sipas Rregullores përkrahet me mjete financiare në shumë prej **200.00€ (dyqind euro)** nga kategoria ekonomike mallra dhe shërbime kodi ekonomik 13490-shpenzime të varrimit nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shërbime Publike kodi i programit buxhetor 18017.

2. Mjetet e përcaktuara, në pikën 1. të këtij Vendimi, do të transferohen në xhirollogarinë e Dellta Zenunaj në pajtim me dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi.

3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Shërbime Publike.

4. Vendimi është përfundimtarë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Vendimi t'i dërgohet:

- Dellta Zenunaj,
- Drejtorisë për Shërbime Publike dhe
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ




Kryetari Komunës
z. Ilir FERATI

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-220/2022	Data: Datum: 12.04.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008), bazuar në nenin 81 të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr.05/L-068, Ligjin Nr.05/L-092, bazuar në Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja, shqyrtoj kërkesën e Prokurimit të datës 08.04.2022, për caktimin e Menaxherit të kontratatave dhe Mbikëqyrësit të drejtpërdrejt të Menaxherit të kontratatave për projektin: Lot1“Furnizimi me material stomatologjik”, nxjerr:

V E N D I M

- 1. CAKTOHET:** Menaxhere e kontratës **znj.Fahrije Gashi**, Stomatologe në QKMF dhe Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës **z.Zenel Shatri**, Drejtorë i Drejtorisë për Shëndetësi për projektin: “Furnizimi me material stomatologjik”, me numër të jashtëm prokurimi 633-022-600-1-2-1 dhe me numër të brendshëm prokurimi 633-022-003-121, të cilin projekt e ka fituar për ta realizuar operatori “**METKOS PHARM**” SH.P.K nga Prishtina.
- Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i Menaxherit të kontratës obligohet që të bëjë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës duke zbatuar nenin 61 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01, si dhe Manualin për Përdorim të Modullit për Menaxhim të Kontratës.
- Përgjegjësin për realizimin e projektit të lartcekur e merr Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i Menaxherit të kontratës.
- Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.
- Vendimi është përfundimtar.

Vendimi t'i dërgohet:

- znj.Fahrije Gashi, Stomatologe në QKMF,
- z.Zenel Shatri, Drejtorë i Drejtorisë për Shëndetësi dhe
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj. Zekije SUTAJ



Kryetari Komunës
 Zyrtar Kryesor Administrativ
z.Illir FERATI



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-218/022	Data: Datum: 08.04.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58. pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) në nenin 46, 47. dhe 48. të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016) dhe bazuar në Rregulloren për Mirëmbajtjen, Rregullimin dhe Ruajtjen e Varrezave 01Nr.68/2021 të miratuar me datë 29.06.2021, Drejtoria për shërbime Publike, shqyrtoi kërkesën 08Nr.120-12228 të datës 31.03.2022 të parashtruar nga Besnik Podrimaj nga fsh. Carrallukë Komuna e Istogut, për përkrahje financiare për shpenzimet e varrimit për vdekjen e babait Qazim Podrimaj dhe i propozon Kryetarit të nxjerrë:

V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa 08Nr.120-12228 e datës 31.03.2022 e parashtruar nga Besnik Podrimaj për përkrahje financiare për shpenzimet e varrimit për vdekjen e babait Qazim Podrimaj dhe sipas Rregullores përkrahet me mjete financiare në shumë prej **200.00€ (dyqind euro)** nga kategoria ekonomike mallra dhe shërbime kodi ekonomik 13490-shpenzime të varrimit nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shërbime Publike kodi i programit buxhetor 18017.

2. Mjetet e përcaktuara, në pikën 1. të këtij Vendimi, do të transferohen në xhirollogarinë e **Besnik Podrimaj** në pajtim me dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi.

3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Shërbime Publike.

4. Vendimi është përfundimtarë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Vendimi t'i dërgohet:

- Besnik Podrimaj,
- Drejtorisë për Shërbime Publike dhe
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ

Zekije SUTAJ



	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		
Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	Nr.Br.01-215/022	Data: Datum: 07.04.2022	Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58, pika b të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenin 18 paragrafi 4 të Ligjit NR.06/L - 114 për Zyrat e Publikë, nenin 49 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 90/2010), shqyrtoi kërkesën 01 Nr.016-13712 të datës 07.04.2022 të parashtruar nga Avenita Selmanaj nga fsh. Truhoc, për lejin e pushimit të lehonisë, nxjerr:

V E N D I M

1.MIRATOHET: kërkesën 01 Nr.016/13712 e datës 07.04.2022 e parashtruar nga Avenita Selmanaj, Zyrtare për Pasuri, nga data 31.03.2022 i caktohet pushimi i lehonisë në kohëzgjatje prej 9 muaj.

2. Pushimi, i çekur në pikën 1 të këtij Vendimi ka filluar me:31.03.2022 deri më:31.12.2022, e përmendura duhet të lajmërohet në punë me: 01.01.2023

3. Në 6 muajt e parë të pushimit të lehonisë prej 31.03.2022 deri me 30.09.2022 paguhet nga institucioni me kompensim 70% dhe me 01.10.2022 Avenita duhet të vihet në listën e pagave me zero (0).

4. Mbas gjashtë muajve, 3 muajt në vijim prej 30.09.2022 deri me 31.12.2022) paguhet nga Qeveria e Republikës së Kosovës, me kompensim 50% të pagës mesatare në Kosovë si dhe 3 muaj tjerë pa pagesë mund ti lejohen me kërkesën e të punësuarës.

A r s y e t i m

Avenita Selmanaj, Zyrtare për Pasuri, ka parashtruar kërkesë 01 Nr.016/13712 të datës 07.04.2022 për lejin e pushimit të lehonisë.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e lartpërmendurës dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe i caktohet pushimi i lehonisë në kohëzgjatje prej 9 muaj.

Në pajtim me nenin 49 paragrafi 3 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.90/2010) punëtores i takojnë 6 muaj pushim të lehonisë me pagesë 70% të pagës së marr nga institucioni ku punon, mirëpo nëse donë të kthehet në punë mbas gjashtë muajve është e obliguar që më së voni 15 ditë para përfundimit të pushimit gjashtë muaj të njoftoj: Menaxherin e Personelit se nuk dëshiron të shfrytëzoj pushimin e përcaktuar në kohëzgjatje prej 3 muajve që paguhet nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Zyrtari për paga mëditje dhe kompensime obligohet që pas gjashtë muajve të pushimit të lehonisë punëtores e lartpërmendur të qesë në listën e pagave me zero(0) dhe e njëjta pas 9 muajve obligohet të njoftoj institucionin për ndërprerjen e pushimit të lehonisë apo parashtron kërkesë për vazhdimin e pushimit të lehonisë edhe tre muaj pushim pa pagesë.

Për realizimin e pagës në kohëzgjatje prej 3 muajve përmes MPMS-së punëtorja duhet personalisht t'i drejtohet Entit për Punësim për realizimin e kësaj page.

Për sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Vendimi t'i dërgohet:

- Avenita Selmanaj,
- Zyrtares Financiare-përgjegjëse për paga, mëditje dhe kompensime,
- Menaxherit të Personelit dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj. Zekije SUTAJ




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Municipality of Istog
	01 Nr.213/2022	Data: 07.04.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 58, pika (h) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale; nenin 14, paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe shkresës së MAPL-së Nr.020-508/3 të datës 25.06.2021 me qëllim të realizimit të interesit të përgjithshëm publik i :

Propozon

Kuvendit të Komunës, që në bazë të nenit 11, nenit 12, paragrafi 12.2 pika (d), nenit 14 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale; nenit 5, paragrafi 1, nënparagrafi 1.3 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës; nenit 26, paragrafi 1 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe nenit 83 të Statutit të Komunës së Istogut 01 Nr.62/2010 që në mbledhjen e mbajtur më ___/04/2022 të merr këtë:

VENDIM PËR RISHQYRTIMIN E VENDIMIT TË KUVENDIT TË KOMUNËS 01 NR.51/2021 LIDHUR ME DESTINIMIN PËR VARREZA TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS

1. Destinohet për varreza prona e paluajtshme e komunës, Njësia Kadastrale Kadastrale 257-0, Zona Kadastrale -Vrellë me sipërfaqen prej 1 hektar, 66 ari e 58 metra nga sipërfaqja e përgjithshme prej 102846 m².
2. Qëllimi i destinimit të pronës së paluajtshme e lartcekur është shfrytëzimi vetëm për varreza sipas kërkesës së banorëve të fshatit Vrellë.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi kujdesen: Zyra e Kryetarit, Drejtoria për Kadastër dhe Gjeodezi, Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis dhe Drejtoria për Shërbime Publike.
4. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe 7 ditë pas publikimit në uebfaqe të Komunës.

Arsyetim

Baza ligjore për miratimin e këtij Propozim-Vendimi është përcaktuar me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.06/L-092, Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe Statutit të Komunës së Istogut 01 Nr.62/2010.

Për shkak të mungesës së hapësirës së mjaftueshme për varreza, përfaqësuesi i banorëve të fshatit Vrellë, Idriz Blakaj ka parashtruar kërkesën 01-400-48498 sipas së cilës ka kërkuar që nga sipërfaqja përgjithshme prej 102846 m² e Njesisë Kadastrale 257-0, Zona Kadastrale –Vrellë të ndahet një pjesë e caktuar e kësaj prone për shfrytëzimin e saj për varreza të banorëve të fshatit Vrellë.

Me qëllim të realizimit të interesit publik propozohet destinimi për varreza të pronës së paluajtshme të komunës ashtu siç përcaktohet në nenin 1 të këtij Propozim-Vendimi andaj kërkojmë nga Kuvendi i Komunës miratimin e tij.

Kryetari i Komunës
Ilir FERATI



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Municipality of Istog
	01 Nr.212/2022	Data: 07.04.2022	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 58 pika (h) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale nenin 68, pika 8 e Statutit të Komunës 01 Nr. 62/10 të datës 30.11.2010 dhe shkresën e MAPL-së Nr. 020-326/8 të datës 25.06.2021 i:

Propozon

Kuvendit të Komunës, që në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d) dhe nenit 14 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale; nenit 53 dhe 54, paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe shkresës së MAPL-së Nr. 020-326/8 të datës 25.06.2021 i propozon Kuvendit të Komunës që në mbledhjen e mbajtur më datë __.04.2022 të miratojë anulimin e Vendimit 01 Nr.34/2021 të datës 31.03.2021:

VENDIM PËR ANULIMIN E VENDIMIT TË KUVENDIT TË KOMUNËS 01 NR.34/2021 TË DATËS 31.03.2021

- MIRATOHET** anulimi i Vendimit të Kuvendit të Komunës 01 Nr.34/2021 të miratuar më 31.03.2021 për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në ndërtimore për Njësitë Kadastrale: P-70806048-512-1; P-70806048-512-2; P-70806048-512-4; P-70806048-512-5; P-70806048-516-6 dhe P-70806048-512-7 me sipërfaqe të përgjithshme prej 0.36.85 ha, Zona Kadastrale- Llukac i Thatë të evidentuara sipas certifikatës pronësore në pronësi të Selman Haxhiaj.
- Për zbatimin e këtij Vendimi kujdesen: Zyra e Kryetarit, Drejtoria për Kadastër dhe Gjeodezi dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor dhe Drejtoria e Inspektionit.
- Pas miratimit të këtij vendimi për anulim nga ana e Kuvendit të Komunës dhe dërgimit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal- MAPL i njëjti hyn në fuqi ashtu siç është përcaktuar në nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenin 17 të Rregullores Nr. 02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimit të Akteve të Komunës dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose në ueb faqen e Komunës

Kryetari i Komunës,
Ilir FERATI



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Municipality of Istog
	01 Nr.211/2022	Data: 07.04.2022	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 58 pika (h) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale nenin 68, pika 8 e Statutit të Komunës 01 Nr. 62/10 të datës 30.11.2010 dhe shkresën e MAPL-së Nr. 020-326/8 të datës 25.06.2021 i:

Propozon

Kuvendit të Komunës, që në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d) dhe nenit 14 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale; nenit 53 dhe 54, paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe shkresës së MAPL-së Nr. 020-326/8 të datës 25.06.2021 i propozon Kuvendit të Komunës që në mbledhjen e mbajtur më datë ____04.2022 të miratojë anulimin e Vendimit 01 Nr.33/2021 të datës 31.03.2021:

VENDIM PËR ANULIMIN E VENDIMIT TË KUVENDIT TË KOMUNËS 01 NR.33/2021 TË DATËS 31.03.2021

- MIRATOHET** anulimi i Vendimit të Kuvendit të Komunës 01 Nr.33/2021 të miratuar më 31.03.2021 për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në ndërtimore për Njësitë Kadastrale:P-70806048-138-2, me sipërfaqe të përgjithshme prej 0.19.60 ha, Zona Kadastrale- Llukac i Thatë, e evidentuar sipas certifikatës pronësore në emër të Rexhë Hajraj.
- Për zbatimin e këtij Vendimi kujdesen: Zyra e Kryetarit, Drejtoria për Kadastër dhe Gjeodezi dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor dhe Drejtoria e Inspektionit.
- Pas miratimit të këtij vendimi për anulim nga ana e Kuvendit të Komunës dhe dërgimit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal- MAPL i njëjti hyn në fuqi ashtu siç është përcaktuar në nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenin 17 të Rregullores Nr. 02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimit të Akteve të Komunës dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose në ueb faqen e Komunës



Kryetari i Komunës,
Ilir FERATI

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Municipality of Istog
	01 Nr.210/2022	Data: 07.04.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 58 pika (h) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale; nenin 68, pika 8 e Statutit të Komunës 01 Nr. 62/10 të datës 30.11.2010 dhe kërkesën Nr. 01-016-11513 e qiramarrësit “Te Aleni” i:

Propozon

Kuvendit të Komunës, që në bazë të nenit 12, paragrafi 12.1 dhe 12.2, pika d), nenit 14 dhe nenit 40, paragrafi 40.2, pika L) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale; nenit 53 dhe 57 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative; nenit 27 paragrafi 5 dhe 6 të Rregullores Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe nenit 16, paragrafi 2 të kontratës Nr. 407/2018 të datës 16.07.2018, që në seancën e mbajtur më ___/04/2022 të miratojë këtë:

V E N D I M **PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT TË KUVENDIT TË KOMUNËS** **01 NR.27/2018 të datës 29.03.2018**

- 1. MIRATOHET** shfuqizimi i Vendimit të Kuvendit të Komunës 01 Nr.27/2018 i datës 29.03.2018 sipas të cilit ishte dhënë në shfrytëzim afatshkurtër për 15 vite përmes ankandit publik qiramarrësit “Te Aleni” Njësia Kadastrale P-70806008-00074-11, me sipërfaqe të përgjithshme prej 25023 m², në vendin e quajtur “Fusha e Gjveshur”, pjesa e pronës 1/1, Zona Kadastrale-Vrellë e cila sipas certifikatës pronësorë evidentohet pronë shoqërore-shfrytëzues e mirë e fshatit Vrellë, me qëllim të shfrytëzimit të gurit gëlqeror për prodhimin e rërës për ndërtim.
- 2.** Pas miratimit të këtij vendimi për shfuqizim nga ana e Kuvendit të Komunës dhe dërgimit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal –MAPL i njëjti hyn në fuqi ashtu siç është përcaktuar me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenin 17 të Rregullores (MAPL) Nr. 02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve të Komunës dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose në ueb faqen e Komunës.
- 3.** Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset: Zyra e Kryetarit, Drejtoria për Kadastër dhe Gjeodezi, Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor, Drejtoria e Inspektionit dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

Arsyetim

Sipas Vendimit 01 Nr.27/2018 të miratuar më 29.03.2018 nga Kuvendi i Komunës, Njësia Kadastrale P-70806008-00074-11, me sipërfaqe të përgjithshme prej 25023 m², Zona Kadastrale-Vrellë e cila sipas certifikatës pronësorë evidentohet pronë shoqërore-shfrytëzues e mirë e fshatit Vrellë ishte dhënë në shfrytëzim afatshkurtër për 15 vite përmes ankandit publik të shpallur më 22.05.2018, qiramarrësit “ Te Aleni” me qëllim të shfrytëzimit të gurit gëlqeror për prodhimin e rërës për ndërtim.

Dhënia në shfrytëzim e Njesisë Kadastrale të lartcekur qimarrësit “ Te Aleni” ishte bërë në bazë të çmimit me të lartë të ofertuar në këtë ankand publik sipas Komisionit Komunal Vlerësues të ofertave për dhënien në shfrytëzim të Pronës së komunës, përkatësisht sipas Vlerësimit 01 Nr.62/2018 të datës 22.06.2018 për hapjen e ofertave dhe shpalljes së fituesit “ Te Aleni” sipas ofertës më të volitshme të ofruar. Komisioni Komunal Vlerësues i ofertave për dhënien në shfrytëzim të Pronës ishte themeluar sipas vendimit të Kuvendit të Komunës Nr.19/2018 të datës 29.03.2018.

Pas shpalljes fitues të qiramarrësit “ Te Aleni “ është lidhur kontrata Nr. 407/2018 e datës 16.07.2018 me Komunën, përkatësisht Kryetarin e Komunës si qiradhënës, në të cilën janë përcaktuar me hollësisht të drejtat dhe obligimet e qiramarrësit “ Te Aleni “ dhe qiradhënësit-Komunës së Istogut.

Sipas kërkesës Nr. 01-016-11513 të datës 25.03.2022 të qiramarrësit Fadil Dreshaj “ Te Aleni” për shkak të skadimit të licencës së punës për shfrytëzim e gurit gëlqeror për prodhimin e rërës për ndërtim në pronën e paluajtshme të komunës Njësine Kadastrale P-70806008-00074-11 ka kërkuar shkëputjen e kontratës Nr. 407/2018.

Bazuar në arsyeshmërinë e këtij propozim-vendimi dhe nenin 27 paragrafi 5 të Rregullores Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, kërkoj nga anëtarët e Kuvendit të Komunës që i njëjti të miratohet.

Kryetari i Komunës,
Ilir FERATI



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	01 Nr. 209/2022	Data: 07.04.2022	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 58 pika (h) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale nenin 68, pika 8 e Statutit të Komunës 01 Nr. 62/10 të datës 30.11.2010 dhe shkresën e MAPL-së Nr. 0204-166/9 të datës 25.06.2021 i:

P r o p o z o n

Kuvendit të Komunës, që në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2 pika (d) dhe nenit 14 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale; nenit 53 dhe 54, paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe shkresës së MAPL-së Nr. 0204-166/9 të datës 25.06.2021 i propozon Kuvendit të Komunës që në mbledhjen e mbajtur më datë __.04.2022 të miratojë anulimin e Vendimit 01 Nr.53/2021 të datës 31.05.2021:

VENDIM PËR ANULIMIN E VENDIMIT TË KUVENDIT TË KOMUNËS 01 Nr.53/2021 të datës 31.05.2021

1. **MIRATOHET** anulimi i Vendimit 01 Nr.53/2021 të datës 31.05.2021 për plotësimin dhe ndryshimin e Vendimit 01 Nr.83/2014 të miratuar nga Kuvendi i Komunës më 27.11.2014 për dhënien në shfrytëzim me negocim në kohëzgjatje për 30 vite, pronën e paluajtshme të komunës, Njësinë Kadastrale Nr. 896-0, Zona Kadastrale Sinajë-Zona Industriale, me sipërfaqe prej 16942 m², investitorit Halit Avdijaj, pronar i "AGRËPRODUCT " SHPK. Sipas shkresës së MAPL-së Nr. 0204-166/9 të datës 25.06.2021 për konfirmimin e ligjshmërisë Vendimi 01 Nr.53/2021 është në kundërshtim me nenin 23 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe Rregulloren (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës andaj propozohet anulimi i tij.
2. Mbetet në fuqi Vendimi 01 Nr. 83/2014 i Kuvendit të Komunës i miratuar më 27.11.2014 për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër pronën e paluajtshme të komunës për 15 vite qiramarrësit "AGROPRODUCT " SHPK nga ana e komunës si qiradhënëse.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi kujdesen: Zyra e Kryetarit, Drejtoria për Kadastër dhe Gjeodezi dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria e Inspektionit.
4. Pas miratimit të këtij vendimi për anulim nga ana e Kuvendit të Komunës dhe dërgimit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal- MAPL i njëjti hyn në fuqi ashtu siç është përcaktuar në nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenin 17 të Rregullores Nr. 02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimit të Akteve të Komunës dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose në ueb faqen e Komunës



Kryetari i Komunës,
Ilir FERATI

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-207/2022	Data: Datum: 07.04.2022	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) dhe bazuar në nenin 69 paragrafi 4 i Statutit të Komunës së Istogut 01Nr.62 i miratuar me datën 30.11.2010, për caktimin e zyrtarëve për pranimin e të gjitha faturave nga operatorët ekonomik, nxjerr:

V E N D I M

1. CAKTOHEN: zyrtaret për pranimin e të gjitha faturave nga operatorët ekonomik dhe zyrtaret e caktuar janë si me poshtë:

- 1.1. **z.Illir Ferati**, Kryetar i Komunës
znj.Alketa Bujupaj-Bytyçi, Asistente Administrative pranë Zyrës së Kryetarit,
- 1.2. **z.Arben Kabashi**, Drejtor i Drejtorisë për Administratë Komunale,
z.Kushtrim Gecaj, Zyrtar për Shërbime me Qytetar,
- 1.3. **z.Zenel Shatri**, Drejtor i Drejtorisë për Shëndetësi,
z.Brahim Hetemaj, Udhëheqës i Sektorit për Shëndetësi,
- 1.4. **znj.Elianë Blakaj**, Drejtoresh e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport,
znj.Qefesere Ibrahimaj, Zyrtare e Lartë për Trashëgimi Kulturor dhe Arkiv të Qytetit,
- 1.5. **z.Abedin Kabashi**, Drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike,
z.Blerim Bujupaj, Zyrtar për ndërtimtari,
- 1.6. **z.Naim Behlulaj**, Drejtor i Drejtorisë Komunale për Arsim,
z.Skender Hakaj, Zyrtar i Lartë për Buxhet dhe Financa,
- 1.7. **z.Kushtrim Buleshkaj**, Drejtor i Drejtorisë për Inspektion,
z.Xhavit Blakaj, Udhëheqës i Sektorit për Inspektion,
- 1.8. **z.Xhevat Demaj**, Drejtor i Drejtorisë për Emergjencë, Mbrojtje dhe Shpëtim,
z.Skender Hasngjekaj, Udhëheqës i Sektorit për Siguri dhe Emergjencë,
- 1.9. **z.Astrit Hajrizaj**, Drejtor i Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi,
z.Fadil Kabashi, Udhëheqës i Sektorit për Bujqësi,
- 1.10. **z.Dukagjin Hoxhaj**, Drejtor i Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mjedis,
znj.Elfele Blakaj, Udhëheqëse e Sektorit për Mjedis,
- 1.11. **z.Agon Dreshaj**, Drejtor i Drejtorisë për Kadastër dhe Gjeodezi,
z.Naim Demaj, Zyrtar për Kadastër dhe Gjeodezi 4,
- 1.12. **z.Genc Ademaj**, Drejtor i Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim,
znj.Arta Fetahu, Zyrtare për Planifikim dhe Zhvillim,
znj.Emina Coković, Drejtorja për Buxhet dhe Financa.
- 1.13. **znj.Merita Bytyçi**, Drejtoresh e Drejtorisë për Mirëqenie Sociale,
z.Fisnik Shoshi, Zyrtar Ligjor 2.

2. Të gjithë zyrtaret e cekur me lartë obligohen të pranojnë të gjitha faturave nga operatorët ekonomik secili për Drejtorin e tyre dhe në afat prej tri ditësh të nisi procedurën e pagesës së faturës në të kundërtën marrin përgjegjësi ligjore për mos procedim të pagesës së faturës me kohë.

3. Zyrtaret e caktuar obligohen t'i dërgojnë faturat për protokollim tek **znj.Shahe Visoqi**, Zyrtare për Buxhet dhe Financa 1.

4. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të kujdesen të gjithë zyrtaret e caktuar nga Drejtorët Drejtorive.

5. Vendim është përfundimtar.

Vendimi t'i dërgohet:

- Të gjithë zyrtarëve të caktuar,
- Drejtorëve të Drejtorive
- Shahe Visoqit dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-206/022	Data: Datum: 07.04.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58. pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) në nenin 46, 47. dhe 48. të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016) dhe bazuar në Rregulloren për Mirëmbajtjen, Rregullimin dhe Ruajtjen e Varrezave 01Nr.68/2021 të miratuar me datë 29.06.2021, Drejtoria për shërbime Publike, shqyrtoi kërkesën 08 Nr.120-13557 të datës 07.04.2022 të parashtruar nga Januz Gjocaj nga fsh.Tomoc Komuna e Istogut, për përkrahje financiare për shpenzimet e varrimit për vdekjen e babait Halil Gjocaj dhe i propozon Kryetarit të nxjerrë:

V E N D I M

- 1. MIRATOHET:** kërkesa 08 Nr.120-13557 e datës 07.04.2022, e parashtruar nga Januz Gjocaj për përkrahje financiare për shpenzimet e varrimit për vdekjen e babait Halil Gjocaj dhe sipas Rregullores përkrahet me mjete financiare në shumë prej **200.00€ (dyqind euro)** nga kategoria ekonomike mallra dhe shërbime kodi ekonomik 13490-shpenzime të varrimit nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shërbime Publike kodi i programit buxhetor 18017.
- 2.** Mjetet e përcaktuara, në pikën 1. të këtij Vendimi, do të transferohen në xhirollogarinë e **Januz Gjocaj** në pajtim me dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi.
- 3.** Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Shërbime Publike.
- 4.** Vendimi është përfundimtarë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimin të këtij Vendimi.

Vendimi t'i dërgohet:

- Januz Gjocaj,
- Drejtoria për Shërbime Publike dhe
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
 znj.Zekije SUTAJ



Kryetari Komunës
 z.Illir FERATI




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-205/022	Data: Datum: 07.04.2022	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), shqyrtoj kërkesën e Prokurimit, për formim të komisionit për verifikimin e punëve për projektin: “Ndërtimi i teshtoreve në stadiumin e futbollit Demush Mavraj” faza e dytë, me numër të jashtëm prokurimi 633-021-2922-5-2-1/C-505, nxjerr:

V E N D I M

1. THEMELIM: Komisioni për verifikimin e punimeve për projektin: “Ndërtimi i teshtoreve në stadiumin e futbollit Demush Mavraj” faza e dytë, me numër të jashtëm prokurimi 633-021-2922-5-2-1/C-505, të cilin projekt e ka realizuar operatori “AAGPROJEKT” SH.P.K dhe në komision caktohen:

- 1.1. Rustem Gashi,** Inxh. i Arkitekturës-Zyrtar i Lartë për Planifikim dhe Zhvillim, Kryesues i Komisionit;
- 1.2. Qefsere Ibrahimaj,** Zyrtare e Lartë për Trashëgimi Kulturor dhe Arkiv të Qytetit, anëtare dhe
- 1.3. Hekuran Rugova,** Zyrtar për Hartimin dhe Përcjelljen e Projekteve, anëtar.

2. Komisioni do të bëjë kontrollimin e tërë dokumentacionit dhe realizimin teknik të projektit të cekur në pikën 1. të këtij Vendimi, sipas projektit detal ekzekutiv; do të njoftojë kryerësin e punëve me të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet sa i përket kryerjes së punimeve; do të njoftoj kompaninë mbikëqyrëse “PMN” SH.P.K; do të hartojë procesverbalin gjatë verifikimit të punimeve në terren; do të hartoj raportin e pranimit teknik të projektit; do të njoftojë Kryetarin lidhur me realizimin punimeve për projektin e lartcekur; si dhe do t’i kryejë edhe punët dhe detyrat tjera që kanë të bëjnë me natyrën e këtij komisioni.

3. Përgjegjësin për verifikimin e punëve për projektin e lartcekur e merr Komisioni ndërsa kompania mbikëqyrëse “PMN” SH.P.K merr përgjegjësin për pranimin e punëve.

4. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij do të kujdeset Komisioni dhe Prokurimi.

5. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:

- Komisionit,
- “PMN” SH.P.K kompani mbikëqyrëse,
- Prokurimi,
- Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport,
- “AAGPROJEKT” -operator dhe
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj. Zekije SUTAJ



Kryetari Komunës
z.Illir FERATI




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Municipality of Istog
	01Nr.Br.204/2022	Data Datum: 07.04.2022	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 58 pika h) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28 e datës 4 qershor 2008) i:

P r o p o z o n

Kuvendit të Komunës, bazuar në nenin 12 paragrafi 12.2 dhe 68 paragrafi 68.4, të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28 e datës 4 qershor 2008), nenin 11,13 të Ligjit Nr.04/L-174 për Planifikimin hapësinor, nenin 7 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ Nr.05/2014(MMPH) për përgjegjësitë e autoriteteve të planifikimit hapësinor si dhe parimet dhe procedurat për pjesëmarrjen e publikut në planifikimin hapësinor, nenin 13 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.04/2018 për transparencë në Komuna dhe Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për standardet minimale të konsultimit publik në Komuna, Njoftimit të Minisitrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës Nr.994-2/22 të datës 04.04.2022, që në këtë mledhje të miratohet Propozim:

Vendim

PËR VËNIEN NË SHQYRTIM PUBLIK TË PROJEKT-DOKUMENTIT TË HARTËS ZONALE TË KOMUNËS SË ISTOGUT 2022-2030.

Neni 1

Me miratimin e këtij propozim vendimi vëhet në shqyrtim publik Projekt-Dokumenti: Harta Zonale e Komunës së Istogut 2022-2030.

Neni 2

Njoftimi publik për projekt-dokumentet e planifikimit hapësinor bëhet së paku tetë(8) ditë para hapjes së shqyrtimit publik.

Neni 3

1.Projekt-Dokumenti spas nenit 1 e këtij vendimi do të publikohet në web faqen zyrtare të Komunës <https://kk.rks-gov.net/istog/>

2. Shqyrtimi Publik zgjat 30 ditë dhe fillon pas përfundimit të afatit sipas nenit 2.

3. Propozimet, sygjerimet apo vërejtjet eventuale paraqiten në formë të shkruar gjatë kohëzgjatjes së shqyrtimit publik për Drejtorinë për Planifikim Urban dhe Mjedis përmes Qendrës për shërbimin e Qytetarëve: Ndërtesa e Komunës si dhe në formë elektronike: info.istog@rks-gov.net

Neni 4

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Dokumenti-Harta Zonale e Komunës së Istogut 2022-2030.

Neni 5

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Planifikim Urban dhe Mjedis.

Neni 6

Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës.

Arsyetim

Baza ligjore për miratimin e këtij Vendimi është përcaktuar me dispozitat e nenit 12 paragrafi 12.2 dhe 68 paragrafi 68.4, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008; nenit 11,13 të Ligjit nr.04/L-174 për Planifikimin hapësinor, nenit 7 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ nr.05/2014(MMPH) për përgjegjësitë e autoriteteve të planifikimit hapësinor si dhe parimet dhe procedurat për pjesëmarrjen e publikut në planifikimin hapësinor, nenit 13 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.04/2018 për transparencë në Komunë, Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.06/2018 për standardet minimale të konsultimit publik në Komunë, Njoftimit të Minisitrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës nr.994-2/22 e datës 04.04.2022.

Sipas procedurave ligjore Dokumenti i hartuar për hartat zonale është dërguar për shqyrtim në Ministrinë për Mjedis, Planifikim Hapësinor dhe Infrastrukturë ku është Rekomanduar për hapjen e shqyrtimit publik.



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-203/022	Data: Datum: 06.04.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58. pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) në nenin 46, 47. dhe 48. të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016) dhe bazuar në Rregulloren për Mirëmbajtjen, Rregullimin dhe Ruajtjen e Varrezave 01Nr.68/2021 të miratuar me datë 29.06.2021, Drejtoria për Shërbime Publike, shqyrtoi kërkesën 01 Nr.120-10480 të datës 17.03.2022 të parashtruar nga Fatime Gerguri nga fsh.Llukac i Thatë, Komuna e Istogut, për përkrahje financiare për shpenzimet e varrimit për vdekjen e nënës Ruka Gerguri dhe i propozon Kryetarit të nxjerrë:

V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa 01 Nr.120-10480 e datës 17.03.2022 e parashtruar nga Fatime Gerguri për përkrahje financiare për shpenzimet e varrimit për vdekjen e nënës Ruka Gerguri dhe sipas Rregullores përkrahet me mjete financiare në shumë prej **200.00€ (dyqind euro)** nga kategoria ekonomike mallra dhe shërbime kodi ekonomik 13490-shpenzime të varrimit nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shërbime Publike kodi i programit buxhetor 18017.

2. Mjetet e përcaktuara, në pikën 1. të këtij Vendimi, do të transferohen në xhirollogarinë e Fatime Gergurit në pajtim me dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi.

3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Shërbime Publike.

4. Vendimi është përfundimtarë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Vendimi t'i dërgohet:

- Fatime Gerguri,
- Drejtorisë për Shërbime Publike dhe
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ

[Signature]

Kryetari Komunës
z.Illir FERATI

[Signature]

[Official Seal of Istog Municipality]

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-202/022	Data: Datum: 06.04.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58, pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) në nenin 46, 47. dhe 48. të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016) dhe bazuar në Rregulloren për Mirëmbajtjen, Rregullimin dhe Ruajtjen e Varrezave 01Nr.68/2021 të miratuar me datë 29.06.2021, Drejtoria për shërbime Publike, shqyrtoi kërkesën 08 Nr.120-7191 të datës 23.02.2022 të parashtruar nga Sali Berisha nga fsh.Dobrushë Komuna e Istogut, për përkrahje financiare për shpenzimet e varrimit për vdekjen e nënës Shera Berisha dhe i propozon Kryetarit të nxjerrë:

V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa 08 Nr.120-7191 e datës 23.02.2022 e parashtruar nga Sali Berisha për përkrahje financiare për shpenzimet e varrimit për vdekjen e nënës Shera Berisha dhe sipas Rregullores përkrahet me mjete financiare në shumë prej **200.00€ (dyqind euro)** nga kategoria ekonomike mallra dhe shërbime kodi ekonomik 13490-shpenzime të varrimit nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shërbime Publike kodi i programit buxhetor 18017.

2. Mjetet e përcaktuara, në pikën 1. të këtij Vendimi, do të transferohen në xhirollogarinë e **Sali Berisha** në pajtim me dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi.

3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Shërbime Publike.

4. Vendimi është përfundimtarë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Vendimi t'i dërgohet:

- Sali Berisha,
- Drejtorisë për Shërbime Publike dhe
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ



Kryetari Komunës
z.Illir FERATI



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-201/022	Data: Datum: 06.04.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58. pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) në nenin 46, 47. dhe 48. të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016) dhe bazuar në Rregulloren për Mirëmbajtjen, Rregullimin dhe Ruajtjen e Varrezave 01Nr.68/2021 të miratuar me datë 29.06.2021, Drejtoria për shërbime Publike, shqyrtoi kërkesën 01Nr.120-12392 të datës 31.03.2022 të parashtruar nga Vedat Brahimaj nga fsh. Kašhiçë Komuna e Istogut, për përkrahje financiare për shpenzimet e varrimit për vdekjen e babait Adem Brahimaj dhe i propozon Kryetarit të nxjerrë:

V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa 01Nr.120-12392 e datës 31.03.2022 e parashtruar nga Vedat Brahimaj për përkrahje financiare për shpenzimet e varrimit për vdekjen e babait Adem Brahimaj, dhe sipas Rregullores përkrahet me mjete financiare në shumë prej **200.00€ (dyqind euro)** nga kategoria ekonomike mallra dhe shërbime kodi ekonomik 13490-shpenzime të varrimit nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shërbime Publike kodi i programit buxhetor 18017.

2. Mjetet e përcaktuara, në pikën 1. të këtij Vendimi, do të transferohen në xhirollogarinë e Vedat Brahimaj në pajtim me dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi.

3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Shërbime Publike.

4. Vendimi është përfundimtarë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Vendimi t'i dërgohet:

- Vedat Brahimaj,
- Drejtorisë për Shërbime Publike dhe
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ





 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-197/022	Data: Datum: 05.04:2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58. pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) në nenin 46, 47. dhe 49. të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016) në nenin 68.1 pika 2. të Statutit të Komunës 01 Nr.62/10 dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014 e miratuar me datë 08.08.2019, shqyrtoi kërkesën 12 Nr.016-12535 të datës 01.04.2022 të parashtruar nga Arton Haxhijaj, përfaqësues i OJQ-së “Klubi i Pingpongut Istogu”, për përkrahje financiare, nxjerrë:

V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa 12 Nr.016-12535 e datës 01.04.2022 e parashtruar nga Arton Haxhijaj, përfaqësues i OJQ-së “Klubi i Pingpongut Istogu”, për përkrahje financiare dhe i ndahen mjete financiare në shumë prej **50.00€ (pesëdhjetë euro)** nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nga programi buxhetor i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, me qëllim të shënimit të ditës botërore të Pingpongut i cili do të mbahet në parkun e qytetit në Istog me datë 06.04.2022.

2. Mjetet e përcaktuara, në pikën 1. të këtij Vendimi, do të transferohen në xhirollogarinë e OJQ-së “Klubi i Pingpongut Istogu”, në pajtim me dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi.

3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.

4. Vendimi është përfundimtarë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi t'i dërgohet:

- Arton Haxhijaj, përfaqësues i OJQ-së “Klubi i Pingpongut Istogu”,
- Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport dhe
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ,



Kryetari Komunës
z.Illir FERATI




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	01 Nr.196/2022	Data: Datum: 05.04.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika (b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenin 22 paragrafi 2 nënparagrafi 2.2. të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.72/2010) dhe nenit 19 të Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, shqyrtoj lajmërimin 02 Nr.46/2022 të datës 01.04.2022 të parashtruar nga Menaxheri i Personelit për pagesën e një page mujore me përfundimin e shërbimit-pensionimin e Ismet Avdylaj, nëpunës civil me titull të vendit të punës: Zyrtare për Buxhet dhe Financa, nxjerr:

V E N D I M

1. **KOMPENZOHE**t: **Ismet Avdylaj**, nëpunës civil me titull të vendit të punës: Zyrtar për Buxhet dhe Financa në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa në lartësi prej një page mujore të cilën e ka realizuar deri në pensionim.
2. Nëpunësit civil të lartpërmendurës i përfundon shërbimi me **24.04.2022**.
3. Pagesa e mjeteve të cekura në pikën 1. e këtij Vendimi, do të bëhet nga programi buxhetor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa.
4. Zyrtari Financiar për Paga, Mëditje dhe Kompensime obligohet që Ismet Avdylaj t'ia bëjë pagesën e një page mujore të realizuar, sipas procedurave të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.
5. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Administratë Komunale, Zyrtari Financiar për Paga, Mëditje dhe Kompensime dhe Menaxheri i Personelit.
6. Vendimi është përfundimtar.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi është e lejuar ankesa Komisionit për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave, në kuadër të organeve të administratës komunale, në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimin të këtij Vendimi.

Vendimi t'i dërgohet:

- Ismet Avdylaj,
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,
- Zyrtari Financiar për Paga, Mëditje dhe Kompensime
- Menaxheri i Personelit dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog-Municipality
	01 Nr.195/2022	Data: Datum: 05.04.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika (b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenin 22 paragrafi 2 nënparagrafi 2.2. të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.72/2010) dhe nenit 19 të Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, shqyrtoj lajmërimin 02 Nr.45/2022 të datës 01.04.2022 të parashtruar nga Menaxheri i Personelit për pagesën e një page mujore me përfundimin e shërbimit-pensionimin e Ramë Elezaj, nëpunës civil me titull të vendit të punës: Zyrtar për Shërbim me Qytetar, nxjerr:

V E N D I M

1. **KOMPENZOHE****T: Ramë Elezaj**, nëpunës civil me titull të vendit të punës: Zyrtar për Shërbim me Qytetar në Drejtorinë për Administratë Komunale në lartësi prej një page mujore të cilën e ka realizuar deri ne pensionim.
2. Nëpunësit civil të lartpërmendurës i përfundon shërbimi me **11.04.2022**.
3. Pagesa e mjeteve të cekura në pikën 1. e këtij Vendimi, do të bëhet nga programi buxhetor i Drejtorisë për Administratë Komunale.
4. Zyrtari Financiar për Paga, Mëditje dhe Kompensime obligohet që Ramë Elezaj t'ia bëjë pagesën e një page mujore të realizuar, sipas procedurave të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.
5. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Administratë Komunale, Zyrtari Financiar për Paga, Mëditje dhe Kompensime dhe Menaxheri i Personelit.
6. Vendimi është përfundimtar.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi është e lejuar ankesa Komisionit për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave, në kuadër të organeve të administratës komunale, në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi t'i dërgohet:

- Ramë Elezaj,
- Drejtorisë për Administratë Komunale,
- Zyrtari Financiar për Paga, Mëditje dhe Kompensime
- Menaxheri i Personelit dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
 znj. Zekije SUTAJ

[Signature]



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-187/2022	Data: Datum: 04.04.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenin 46, 47. dhe 48. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016) dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014. Komisioni për shqyrtimin e kërkesave të qytetarëve për përkrahje financiare në shëndetësi, Komisioni për vlerësim dhe shqyrtim të kërkesave shëndetësore për përkrahje financiare shqyrtoi kërkesën Nr.06-553-12234 të datës 31.03.2022 të parashtruar nga z.Lekë Gojani nga f.sh Kosh, Komuna e Istogut, për përkrahje me karburant për dërgimin e nënës Gjyla Gojani në Spitalin e Përgjithshme në Pejë për marrjen e dializës dhe i propozon Kryetarit të nxjerri:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa Nr.06-553-12234 e datës 31.03.2022 e parashtruar nga **z.Lekë Gojani** për përkrahje me karburant, për dërgimin e nënës Gjyla Gojani në Spitalin e Përgjithshme në Pejë për marrjen e dializës tri herë në javë dhe i lejohen 57 litra karburant .
2. Obligohet Zyrtari i transportit që z.Lekë Gojani të pajisë me vërtetim për furnizim me karburant të automjetit si në pikën 1. të këtij Vendimi, në pajtim me procedurat të cilat vlejnë për furnizim me karburant të automjeteve zyrtare, nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi.
3. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij, do të kujdeset: Drejtoria për Shëndetësi dhe Zyrtari i Transportit.
4. Vendimi është përfundimtarë.

A r s y e t i m

z.Lekë Gojani, ka parashtruar kërkesën Nr.06-553-12234 të datës 31.03.2022, me të cilën ka kërkuar që t'i mundësohet furnizimi me karburant për automjetin më të cilin bëhet dërgimi i nënës tri herë në javë në Spitalin e Përgjithshme në Pejë për marrjen e dializës.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurit dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton.

Nga kërkesa e parashtruar dhe raportet mjekësore shihet se Gjyla Gojani është e sëmurë dhe i ndihmohet me 57 litra karburant për mbushjen e veturës për dërgimin e saj për marrjen e dializës tri herë në javë në Spitalin e Përgjithshme në Pejë.

I lartpërmenduri është në gjendjen ekonomiko sociale jo të mirë dhe nuk ka mundësi familja me i bartë të gjitha shpenzimet e transportit për dërgimin e nënës për marrjen e dializës.

Zyrtari i transportit Lekën do të pajisë me vërtetim për furnizim me karburant nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi në pajtim me procedurat që vlejnë edhe për automjetet zyrtare.

Drejtorja për Shëndetësi do të kujdeset që të bëhet furnizimi i automjetit me karburant dhe do të përcjellë realizimin e këtij Vendimi.

Për sa u tha me lartë u vendos si në diapozitiv të këtij Vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi t'i dërgohet:

- z.Lekë Gojani,
- Drejtorisë për Shëndetësi,
- Zyrtarit të Transportit dhe
- Arkivin e zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
 znj. Zekije SUTAJ




Kryetari Komunës
 Z.Illir FERATI